



**VENDIM**

**Nr. 66 Datë 27.07.2011**

**PËR**

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “IDRO ENERGJIA PULITA” SH.P.K  
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve; 8 pika 2 gërma “a”, 9, 13 pika 1, gërma “a” dhe 15 pika 3, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1 gërma “a”, 12, 13, 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.07.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “IDRO ENERGJIA PULITA” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “IDRO ENERGJIA PULITA” sh.p.k plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes është në proces miratimi.(neni 9 pika 4.1.5).

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “IDRO ENERGJIA PULITA” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gostivisht” me fuqi 1.3 MW, “Langarica 3” me fuqi 2.2 MW dhe “Ura e Dashit” me fuqi 1.2 MW për një afat 30 vjeç me kusht që:  
Shoqëria “IDRO ENERGJIA PULITA” sh.p.k të dorëzojë  
“Miratimin e Pikës së Lidhjes me Sistemin e Shpërndarjes”  
brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licensës .
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**